



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË

I. Numër: 01-016/01-48712, datë: 31 Korrik 2026

Në bazë të nenit 11, nenit 12. paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), dhe nenit 24. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 2, pika 2.3 të Ligji Nr. 03/L – 049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me ligjin Nr. 05/L-007, Ligjit Nr. 10/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431, dt. 30 Shtator 2020, Kuvendi i Komunës së Pejës, në takimin e mbajtur me datë: 31 Korrik 2026, më propozim të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi (DBPH) dhe kryetarit të Komunës, merr:

VENDIM

Nr. 78/2026

për buxhetim në bashkëfinancim të projektit “furnizim me mekanizëm bujqësor – 65 Traktorë për fermerët e Komunës së Pejës” në mes të Komunës së Pejës dhe participimit të fermerëve/bujqitë përfitues

1. **MIRATOHET** propozimi i DBPH-së dhe Kryetarit të Komunës së Pejës, për buxhetimin nga bashkëfinancimi për projektin “furnizim me mekanizëm bujqësor – 65 Traktorë për fermerët e Komunës së Pejës”, në mes të Komunës së Pejës më 60% i vlerës totale dhe participimit nga fermerët/bujqitë përfitues më 40% i vlerës totale.
2. Në kuadër të projektit të lartcekur, Komuna e Pejës do të sigurojë pjesën e fondeve në vlerë prej, 418,470,00 € (katërqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë euro), ndërsa fermerët përfitues do të participojnë më kontribut financiar në shumën prej 278,980.00 € (dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë euro).
3. Në total vlera e projektit është 697,450.00 € (gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë euro). Projekt ky në bashkëfinancim: Komuna e Pejës më 60% dhe participimi nga fermerët/bujqitë përfitues më 40%.
4. Shuma e mjeteve 418,470,00 € (katërqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë euro) nga Komuna e Pejës sipas këtij vendimi do të participohen nga Buxheti Komunal Pejë, Kodi Subvencione nga DBPH.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe Drejtorinë për Buxhet e Financa të Komunës së Pejës.

6. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:
MAPL,
Kryetarit të Komunës,
DBPH,
DBF,
Arkiv.



KRYESUESI I KUVENDIT
z. Rexhep Kurtbogaj